

Tako Zotin

Jezusi është përgjigjja *(Marku 2:1–12)*

Unë nuk di çdo gjë për ju, përveçse një gjëje: Ju jeni duke u ballafaquar me disa probleme. Mund të jetë një problem shpirtëror, një problem shëndetësor, një problem financiar, problem familjar apo problem emocional. E vërteta është se ju e keni një problem. Të gjithë hasim vështirësi. Në këtë mësim dua të provoj se Jezusi është përgjigjja për gjithë problemet tona, çfarëdo qofshin ato. E gjithë Dhjata e Re e shpalos këtë të vërtetë, por për qëllimet tona le të shikojmë një pjesë të shkurtër nga jeta e Krishtit, e gjendur te Marku 2:1–12.

KATËR SHOKËT DHE I SËMURI **(MARKU 2:1–4)**

Pjesa fillon kështu: «Pas disa ditësh, ai erdhi përsëri në Kapernaum ...» (v. 1). Kapernaumi ishte kthyer në qendër të veprimtarisë së Jezusit në zonën e Galilesë. Në kapitullin e parë të Markut (1:21), lexojmë rreth vizitës së mëparshme të Jezusit në Kapernaum. Në atë kohë, Jezusi kishte shëruar një njeri të zotëruar nga shpirti i keq (1:23–27) dhe vjehrrën e Pjetrit (1:29–31). Në mbrëmjen e po asaj dite, pas perëndimit të diellit, shumë të sëmurë ishin shëruar (1:32–34). Tani Jezusi ishte kthyer përsëri në Kapernaum.

Ai ndoshta dëshironte të pushonte dhe të merrte veten nga lodhja e udhëtimeve në Galile (shënime 1:35, 45), por «u muar vesh se Ai gjendej në shtëpi» (v. 1b). Fjala kaloi nga goja në gojë: «Jezusi është kthyer»!

«Dhe, menjëherë u mblodhën aq shumë njerëz, sa nuk gjeje më vend as përpara derës» (v. 2a). Mikpritja ishte shumë e theksuar në ato kohëra. Dyert e shtëpive liheshin zakonisht hapur gjatë ditës. Njerëzit ishin të mirëpritur për vizita në çdo kohë. Shumë shpejt, shtëpia ku Jezusi po qëndronte, u mbush plot me njerëz. Madje, turma e njerëzve vazhdonte dhe jashtë dyerve.

Vini re fundin e rreshtit 2: «Dhe Ai po u predikonte atyre Fjalën». Jezusi erdhi të kërkojë dhe të shpëtojë të humburit (Luka 19:10). Ky ishte prioriteti i Tij më i madh, gjëja e parë në listën e Tij. Kështu, Ai shfrytëzoi çdo mundësi për të predikuar Fjalën.

Kjo përgatit skenën për ngjarjen e katër shokëve: «Atëhere i erdhën disa që i paraqitën një të paralizuar, që po e mbartnin katër vetë» (v. 3). Le të përqëndrohemi më mirë në çfarë po ndodh. Katër njerëzit kishin një shok që ishte «i paralizuar». Ai ishte i paralizuar, kështu që nuk kishte mundësi të lëvizte, por akoma nuk e dimë të gjithë historinë. Zyrtarët thonë se ai kishte një paralizë, të shoqëruar me kriza si në rastin e epilepsisë.

Kontrolli i muskujve nuk funksiononte, por kishte shpërthime të papritura të dhembjeve, gjatë të cilave i sëmuri rrëzohej dhe përpëlitej në agoni të pafundme, ku shpërthimet e dhembjeve shpesh-toheshin dhe e vetmja zgjidhje dukej se ishte vdekja.

I paralizuari ishte në kushte fizike të tmerrshme!

Nuk e dimë pse i paralizuari nuk qe sjellë te Jezusi gjatë vizitës së Tij të parë në Kapernaum. Ndoshta i paralizuari nuk kishte qenë në qytet, ndoshta shokët e tij nuk kishin qenë në qytet, apo ndoshta ata nuk gjetën kohën ta sillnin të paralizuarin te Jezusi më përpara. Sidoqoftë, të katër shokët nuk humbën kohë kësaj radhe, por ata e sollën të paralizuarin menjëherë te Jezusi. Ata po e sillnin të paralizuarin të shtrirë në krevat, që s'ishte gjë tjetër veçse një dyshek i hollë. (Ndoshta secili mbante nga një cep.)

Ja ku ishin katër individë që e kuptuan se Jezusi ishte përgjigjja apo çelësi. Në fakt e vetmja pëgjigje për problemin e shokut të tyre të paralizuar. Rreshti 5 përshkruan besimin e tyre. Çfarë lloj besimi kishin ata te Jezusi?

Jezusi ka fuqinë për të ndihmuar

Para së gjithash, të katër shokët kishin besim se Jezusi kishte *fuqinë* për të ndihmuar. Fuqia e Jezusit ishte demonstruar gjatë qëndrimit të Tij të fundit në Kapernaum. E njëjta gjë ishte demonstruar edhe gjatë udhëtimit te Tij të suksesshëm në Galile që sapo kishte pëfunduar.

Kjo është e rëndësishme për t'u kuptuar. Të gjithë kemi probleme. Ndonjëherë besojmë se problemet tona janë të veçanta dhe asnjë tjetër nuk ka patur ndonjëherë probleme si këto tonat. Mund të mendojmë se asnjë s'mund të na ndihmojë në problemet tona dhe se ato s'kanë zgjidhje. Është e rëndësishme të kuptohet se «për Perëndinë s'ka asgjë të pamundur» (Luka 1:37)!

Jezusi është i gatshëm të ndihmojë

Sidoqoftë, besimi i këtyre njerëzve ishte më i madh se sa dukej. Ata gjithashtu kishin besim se Jezusi ishte *i gatshëm* ta përdorte fuqinë e Tij për të shëruar të paralizuarin, sepse besonin se Jezusi kujdesej për njerëzit. Ata kishin shumë arsye për ta besuar këtë. Jezusi kishte treguar preokupimin e Tij për hallet e njerëzve gjatë vizitës së Tij të fundit në Kapernaum, por, në mënyrë të veçantë dhembshuria e Jezusit është ilustruar në një ngjarje që ndodhi gjatë udhëtimit të Tij në Galile.

Gjatë atij udhëtimi një mrekulli na është përshkruar me detaje: shërimi i lebrozit. «Dhe erdhi tek Ai një lebroz i cili, duke iu lutur, ra në gjunjë dhe i tha: “Po të duash, Ti mund të më pastrosh”» (Marku 1:40). Përgjigjja e Jezusit

është dhënë me një frazë të shkurtër që mund të anashkalohet: «Dhe Jezusi, duke e mëshiruar, shtriu dorën, e preku dhe i tha: “Po do të shëroj, qofsh i pastruar”» (v. 41).

Disa vjet më parë, Kompania e Telefonave “Bell” organizoi një fushatë reklamimi me sloganin: «*Vepra dhe influenco dikë*». Në reklamë, ai «dikush-i» ishte gjithmonë një pjestar i familjes, një mik, një i njohur, por nuk ishte asnjëherë një njeri i ndarë nga shoqëria, një njeri i sëmurë apo një njeri i hedhur poshtë nga të tjerët. Jezusi, sidoqoftë, veproi, preku dhe influencoi *një lebroz*.

Në atë kohë, termi «lebroz» përmblihte një sërë sëmundjesh që ishin shumë infektive dhe serioze për shëndetin. Lebrozëve u kërkohesh të izoloheheshin nga pjesa tjetër e shoqërisë. Asnjë nuk do të donte t'i afrohej një lebrozi dhe jo më ta *prekte* atë. Megjithatë, Jezusi, «shtriu përpara dorën dhe e preku atë».

Pse e preku Jezusi të sëmurin me lebër? A ishte e nevojshme prekja për ta shëruar? S'e besoj.¹ Jam i sigurt se Jezusi e preku atë për të njëjtën arsye që ne prekim ose ngushëllojmë një njeri që vuan dhe ka dhembje, për të njëjtën arsye që ne i shtrëngojmë dorën dikujt apo e përqafojmë në rast vdekjeje a sëmundjeje. Vëreni përsëri vargun: «*Dhe duke e mëshiruar, Ai shtriu dorën dhe e preku*».

Të katër shokët kurrë s'do të kishin marrë mundimin të sillnin të sëmurin te Jezusi, pa qenë të bindur se Jezusi kishte *mëshirë*. Duhet ta kuptojmë këtë të vërtetë. Jezusi jo vetëm është përgjigjja, por Ai kujdesej për ne. Ai *dëshiron* të na ndihmojë.

Megjithatë, kur katër shokët e sollën të paralizuarin te Jezusi, ata hasën një pengesë. Ata «nuk mundën t'i afrohen Jezusit për shkak të turmës» (v. 4a).² Mos harroni që shtëpia ishte mbushur me njerëz, madje edhe dera ishte bllokuar nga njerëzit (sipas rreshtit 2). N.q.s. unë do të isha njëri prej të katërve, mund të kisha thënë: «Bëmë çfarë mundëm, me mirë e lëmë për sot dhe shkojmë në shtëpi». Ndoshta, do të kisha thënë: «Më mirë ta vendosim shokun e sëmurë nën hijen e ndonjë peme dhe të presim derisa turma e njerëzve të rrallohet».³ Por të katër shokët, sidoqoftë, nuk bënë asnjë nga gjërat që përmenda më lart. Ata e dinin se Jezusi ishte përgjigjja, e vetmja

përgjigje për sëmundjen e shokut të tyre, kështu që ata bënë tri gjëra:

(1) Ata zgjodhën të bënin çfarë ishte *më e vështira*. E ngjitën shokun e tyre lart në çati. Ndoshta shokët përdorën një shkallë të drunjtë për t'u ngjitur mbi çati, ndoshta shtëpia kishte vetë një shkallë të jashme për këtë qëllim. Zakonisht, shtëpitë në Lindjen e Mesme ndërtoheshin ngjitur me njëra-tjetrën. N.q.s. do të kishte ndonjë shkallë të jashtme, ato do të ishin larg nga shtëpia. Të katër shokët mund të kenë kapërcyer nga një çati në tjetrën për të sjellë shokun e tyre të sëmurë. Hamendja ime më thotë se ata gjetën një shkallë të vjetër dhe gjysmë të shkatërruar, e vendosën anash murit dhe e ngjitën shokun e tyre nga shkalla. Ata përdorën çdo mundësi që kishin për ta ngjitur shokun e tyre në çati. Ata bënë më të vështirën.

(2) Ata bënë diçka që nuk pritej nga të tjerët: «Ata zbuluan çatinë» (v. 4b). Me të vërtetë, «ata zbuluan çatinë». Në ato kohëra shumë çati ishin ndërtuar duke vendosur trarë lart, nga njëri kënd i murit në tjetrin. Degë pemësh dhe ristela të mbuluara me baltë dhe kashtë vendoseshin mbi trarët. Balta, pasi njomej me ujë, petëzohej dhe lihej në diell, derisa të piquej. Të katër shokët «hapën një vrimë» në çati (v. 4c).

(3) Ata zgjodhën rrugën *më të kushtueshme*. Vendoseni për një moment veten në vend të të zotit të shtëpisë. Me shumë vëmendje po dëgjoni predikimin e Jezusit. Papritmas, dëgjoni një zhurmë në çati. Pluhur, copa balte dhe degësh fillojnë të bien në dhomë. Shikoni lart dhe vini re se çatia e shtëpisë tuaj po shkatërrohet. Ç'farë do të mendonit? Ndoshta, do të mendonit: «Kush do ta rregullojë çatinë time tani»? Dhe përgjigja e menjëhershme do të ishte: «Katër shokët që e shkatërruan»! Ata duhet ta rregullojnë çatinë, përndryshe, duhet të paguajnë për dëmin e shkaktuar! Pavarësisht nga kostoja, ata nuk u tërhoqën, por e ndihmuan shokun e tyre për të takuar Jezusin.

Në klasat për fëmijë, mësimi që del nga kjo ngjarje është rëndësia e miqësisë. Sa shokë të mirë ishin këta të katër dhe çfarë shembulli i mirë janë ata për ne. Ne të gjithë njohim njerëz që kanë nevojë për Perëndinë. Ndoshta këta njerëz vuajnë. Ndoshta kanë shumë probleme. Ndoshta kanë nevojë për shpëtim dhe as nuk e kuptojnë. Çfarë

përpjekjesh apo sakrificash jemi gati të bëjmë për t'i ndihmuar dhe për t'i afruar ata te Jezusi? A ndodh që përiqemi një herë të vetme dhe kur ata thonë «Jo», ne mendojmë: «Të paktën ne u përpoqëm të bënim diçka» dhe dorëzohemi? A ndodh që vazhdojmë të presim «derisa turma të rrallohet», apo presim derisa koha të jetë më e përshtatshme për ne?

Le të themi të vërtetën. Për shumë nga ne po bëhet gjithnjë e më e vështirë për t'u folur të tjerëve për Jezusin. «Turma» na ka zënë rrugën. Miqtë dhe shokët tanë duken gjithmonë të zënë dhe ne mendojmë se s'kemi kohë të mjaftueshme për asgjë Indiferenca e tyre dhe indiferenca jonë na kanë zënë rrugën. Megjithatë, n.q.s. jemi të bindur me gjithë zemër se Jezusi është zgjidhja, e vetmja zgjidhje për hallet dhe problemet e njerëzve që janë të dashur për ne, atëhere ne nuk do të lëmë gurë pa lëvizur derisa ata ta njohin Jezusin! Ne do të jemi gati të bëjmë atë që është më e vështirë, më e pamundur dhe më kushtueshme!

JEZUSI DHE I SËMURI (MARKU 2:5-12)

Tani le të shkojmë te pjesa e fundit e ngjarjes, ku Jezusi dhe i sëmuri takohen dhe le të shikojmë se si Jezusi është çelësi për zgjidhjen e çdo problemi. Vëmendja zhvendoset nga të katër shokët te Jezusi.

... zbuluan çatinë në vendin ku ndodhej Jezusi dhe, mbasi hapën një vrimë, e lëshuan vigun mbi të cilin rrinte shtrirë i paralizuari. Jezusi, kur pa besimin e tyre, i tha të paralizuarit: «Biri im, mëkatet e tua janë falur!» (vargjet 4, 5).

Imagjinojeni Jezusin duke qëndruar në mes të turmës në dhomë. Ai po bënte të pamundurën t'u shpjegonte njerëzve se kush ishte Perëndia. Papritur, pluhur dhe mbeturina filluan të bien rreth e rrotull tij. Kur Jezusi shikoi lart, çatia ishte gjysmë e shkatërruar dhe një vrimë e madhe ishte hapur. Papritur katër fytyra u dukën lart, ndërsa po përiqeshin ta zgjeronin vrimën më shumë. Më në fund, vrima ishte e mjaftueshme për të ulur të paralizuarin. Duke treguar shumë kujdes, të katër shokët e ulën shokun e tyre të paralizuar nga çatia në mes të dhomës, para këmbëve të Jezusit. Si reagoi Jezusi? Si do të kishit reaguar ju apo unë?

Përfytyroni një kishë gjatë një shërbese të

dielën, duke dëgjuar me vëmendje të madhe predikuesin, ndërsa ai po prezanton një mësim të fuqishëm nga Bibla. Papritur, ata dëgjojnë zhurma njerëzish në çati, goditjet e çekanëve dhe uturimën e sharrave. Një zgavër e madhe është hapur në tavan. Pjesë të tavanit bien në dyshe duke shkaktuar zhurmë të madhe. Ndërsa hedhin sytë lart, një njeri i shtrirë në dyshek, që mbahet në të katër cepat me litar, po zbret drejt e në qendër të kishës. Cili do të ishte reagimi i kishës? Mund të thonë: «Po ju pse s'përdorni derën kryesore si çdo njeri tjetër»? Ndoshta njerëzit do të reagojnë me inat: «Si guxon të shkatërroni ndërtesën tonë!? Si guxon që ndërprisni shërbesën!? A nuk e dini ju se ne këtu po përiqemi të nderojmë me seriozitet»?

Jezusi mund të kishte reaguar në këtë mënyrë: «Sa e pahijshme! Ju po ndërprisni shërbesën Time! Jo vetëm kaq, por ju po fyeni të zotin e shtëpisë, i cili me gjithë zemër ka hapur shtëpinë e tij për këtë takim»! Por, ndryshe nga ç'pritej, Jezusi nuk u përgjigj në këtë mënyrë. Është e mrekullueshme të dimë se mund ta ndërpresim Zotin, megjithëse Ai është i zënë me punë më të rëndësishme. Ai vetë «i mban të gjitha gjërat me fuqinë e fjalës së Tij» (Hebrenjve 1:3), por, pavarësisht nga kjo, ne mund t'i afrohem Jezusit me gjithë dobësitë tona njerëzore dhe Ai do të lërë gjithçka e do të na dëgjojë.

Si reagoi Jezusi? Ai vështroi të sëmurin para këmbëve të Tij. Jezusi pa jo vetëm sëmurdjen e trupit të tij, por kuptoi edhe dëshpërimin që mbushte zemrën e tij. Ishte e qartë se ndjenja e fajit për mëkatet e të kaluarës, po ia gërryente shpirtin të sëmurit. Prandaj Jezusi i tha të paralizuarit: «Biri im, mëkatet e tua janë falur». Në tekstin origjinal, fjala e përkthyer si «bir» është fjala «fëmijë i vogël», term që përdoret për të shprehur dashuri. Gjithashtu, në origjinal, thksohet fjala «falur».⁴ Fjalë për fjalë fjalia lexohet: «Fëmijë i vogël, të falura janë mëkatet e tua». Jezusi është, para së gjithash, përgjigja për problemin e mëkatit.

Ky rresht nuk na mëson se problemet fizike të të paralizuarit ishin rezultat i drejtpërdrejtë i problemeve të tij shpirtërore.⁵ Në kapitullin e nëntë të Gjonit, Jezusi thekson se nuk ka ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë midis mëkatit personal dhe problemeve shëndetësore (v. 2 e më tej).

Përkundrazi, ky varg na bën të njohur se *shqetësimi kryesor i Jezusit s'ishte për problemet shëndetësore të të sëmurit, por ishte për problemet e tij shpirtërore*. Jezusi në fillim po kujdesej për problemin më të rëndësishëm.

Përgjigja për problemin e mëkatit

Kur themi se Jezusi është përgjigja për çdo problem, duhet të kuptojmë se, para së gjithash, Ai është përgjigja për problemin e mëkatit. Detyra kryesore e Jezusit, kur erdhi në tokë, s'ishte të kujdesej për problemet shëndetësore të njerëzve ... apo të sillte ndonjë psikologji apo filozofi të re për jetën, për të na ndihmuar të zgjidhim problemet tona. Perëndia mund të kishte dërguar për këtë mision një mësues shumë të aftë. Perëndia s'kishte pse t'i merrte qiellit xhevahirin më të çmuar. Ai s'kishte pse të dërgonte Birin e Tij të vetëm të vdiste në kryq! Por, Jezusi erdhi që të merrej kryesisht me problemin e mëkatit, sepse vetëm Ai mund ta bante këtë. Ai theksoi: «Biri i Njeriut ka ardhur të kërkojë dhe të shpëtojë atë që kishte humbur» (Luka 19:10).

Ndoshta në këtë moment po vuani përbrenda. Ndoshta vuani nga dhembja. Trupi dhe mendja juaj mund të jenë duke u përgjyeruar për lehtësim. N.q.s. kërkon lehtësim, në fillim duhet të *pyesni* veten: «Cila është situata ime shpirtërore? Cila është marrëdhënia ime me Perëndinë»? Sot ne jetojmë në një botë ku prioritet kanë gjërat që s'janë dhe aq të rëndësishme. Për shembull, sot ne dëgjojmë shumë fjalime për ekologjinë dhe mjedisin. Unë jam dakord që ne duhet të kujdesemi për botën. Perëndia ia dha njeriut këtë tokë dhe e ngarkoi atë me detyrën që ta punojë dhe të kujdeset mirë për të (Zanafilla 1:28; 2:15). Megjithatë dëgjoj njerëz që të pushtuar nga paniku thonë: «Në fund të fundit, kjo (toka) është e vetmja shtëpi që njerëzimi ka»! Unë s'flas dot në emër të të tjerëve, por për vetem time *unë* kam një shtëpi më të mirë (Gjoni 14:1–3)! Pastaj dëgjoj për yje kinemaje dhe televizionin, këngëtarë rroku dhe njerëz të tjerë të dëgjuar që ankohen për ndotjen e ajrit dhe ujit, kur në të njëjtën kohë ata po ndotin mendjet dhe shpirtrat e brezit të ri!⁶ Shpresoj që asnjë nga ne nuk kontribuon në ndotjen e planetit, por kjo tokë nuk u krijua si një vend i përhershëm për të jetuar (2 Pjetrit 3:10–13). Shkatërrimi i shpirtëve të pavdekshëm ka pasojat

më të mëdha!

Një nga gjërat që është shpjeguar më mirë në Bibël, është fakti se shpirti i njeriut është me i rëndësishëm se bota rreth tij. Në kapitullin e dytë të Markut, Jezusi u kujdes më parë për problemin shpirtëror të të sëmurit dhe më pas për problemin e tij shëndetësor. N.q.s. po vuani, s'ka rëndësi nga se, lejojeni Jezusin që në fillim të kujdeset për problemin tuaj shpirtëror.

Përgjigjja për çdo problem të jetës

Pasi u kujdes për problemin kryesor të të sëmurit, Jezusi e ktheu vëmendjen në problemin e tij dytësor, për të treguar se Ai kujdeset për gjithçka.

Vargu tjetër tregon se kritikët e Jezusit ishin të pranishëm, kur Ai foli: «Por aty po rrinin ulur disa skribë që po arsyetonin në mendjen e tyre» (v. 6). Fjala «skribë» nënkupton ata që kanë përgjegjësi për të kopjuar ligjin e Moisiut. Skribët konsideroheshin si ekspertë në njohjen dhe interpretimin e ligjit të Perëndisë në Izrael. Ata ishin shumë të rreptë në zbatimin e rregullave dhe përpiqeshin të kontrollonin çdo veprim të Jezusit.⁷ S'ka dyshim se çdo njeri i dëgjonte, kështu që ata i kishe në krye të vendit në çdo kohë.

Ata po arsyetonin në mendjen e tyre: «Ky po blasfemon. Kush mund të falë mëkatet, veç Perëndisë vetë?» (v. 7). Pjesërisht ata kishin të drejtë! Sot disa njerëz thonë se Jezusi ishte njeri i mirë, por jo Hyjnor. Pra, n.q.s. Jezusi nuk ishte Zot, Ai ishte një blasfemues dhe meritonte vdekjen (Lev. 24:16). Më tej, skribët mund të kenë menduar: «A është e mundur që Jezusi të jetë Zot?» Fatkeqësisht, paragjykimi i tyre nuk do t'i lejonte t'i përgjigjeshin pozitivisht kësaj pyetjeje.

«Por Jezusi, i cili menjëherë kuptoi në frymën e vet se ata po i mendonin këto gjëra në veten e tyre, u tha atyre: “Pse i mendoni këto gjëra në zemrën tuaj?”» (v. 8). Fakti që Jezusi mund të kuptonte mendimet e tyre do t'i ketë habitur ata! «Çfarë është më e lehtë, t'i thuash të paralizuarit: “Mëkatet e tua të janë falur”, apo t'i thuash: “Çohu, merre vigun tënd dhe ec”?» (v. 9). Natyrisht, është më e lehtë të thuash: «Mëkatet e tua janë të falura». Çdo sharlatan mund ta thoshte këtë.

Jezusi vazhdoi: «Dhe tani, që ta dini se Biri i

njeriut ka pushtet të falë mëkatet mbi dhe ...» (v. 10). Termi «Biri i Njeriut» ishte përdorur nga Danieli për t'iu referuar Mesisë.⁸ Jezusi deklaroi veçantinë e Tij! Jezusi ishte i vetmi që pati pushtetin të falë mëkatet e njerëzve.⁹ Gjatë kohës që ishte në tokë, Ai e përdori këtë pushtet vetëm tri herë.¹⁰ Për ta përfocuar më shumë autoritetin e tij Ai i tha të paralizuarit: «Unë po të them: Çohu, merr vigun tënd dhe shko në shtëpinë tënde» (v. 11).

Jezusi përdori aftësinë e Tij për t'u kujdesur edhe për problemin *dytësor* të të paralizuarit, për sëmundjen e tij, në mënyrë që Ai të vërtetonte se kishte aftësi për të zgjidhur problemin *parësor* të të sëmurit, fajin e mëkateve të tij. Apostulli Pal përdor një varg të ngjashëm në librin e Romakëve, vetëm se Pali argumenton pak ndryshe: «Sepse Ai (Perëndia) që nuk e kurseu Birin e vet, por e dha për të gjithë ne, qysh nuk do të na dhurojë të gjitha gjërat bashkë me të?» (Romakëve 8:32). Me fjalë të tjera, n.q.s. Perëndia kujdeset për problemin tonë parësor, problemin e mëkatit, Ai gjithashtu do të kujdeset për çdo problem dytësor që ne mund të kemi.

Më pas Jezusi tha: «Çohu, merr vigun tënd dhe shko në shtëpi». A mund ta imagjinoni habinë e të gjithë të pranishmëve?! Çdo shikim u kthye tek i paralizuari. N.q.s. i paralizuari s'do të kishte lëvizur nga vendi, çdo njeri i zhgënjyer do të ishte larguar për në shtëpi, duke thënë: «Ne menduam se Mesia kishte ardhur, por u gabuam përsëri». Por, në anën tjetër, çfarë do të ndodhte, n.q.s. i sëmuri do të ishte ngritur, do të kishte marrë me vete rrogzin mbi cilin shokët e tij e kishin sjellë dhe do të kishte dalë jashtë derës? Cili do të ishte reagimi? Jezusi do të kishte vërtetuar se Ai është përgjigjja apo çelësi për *çdo* problem në jetë!

«Dhe ai u ngrit menjëherë, mori vigun e vet dhe doli përjashta në praninë e të gjithëve» (v. 12a)! Si të gjitha mrekullitë e Dhjatës së Re kjo mrekulli ishte e shpejtë, e plotë dhe bindëse (jo si disa «mrekulli» të sotme). Shkrimtarët e Ungjijve kanë përdorur gati çdo fjalë që gjendet në fjalor për të përshtetur reagimin e dëshmitarëve. Marku thotë: «Kështu të gjithë u habitën dhe lëvduan Perëndinë duke thënë: Një gjë të tillë s'e kemi parë kurrë!» (v. 12b). Mateu shkruan se «ata ishin shumë të çuditur dhe lëvdonin Perëndinë,

që u kishte dhënë pushtet të tillë njerëzve» (Mateu 9:8). Luka e përshkruan në këtë mënyrë skenën: “Dhe të gjithë u habitën dhe lëvdonin Perëndinë dhe, plot frikë, thoshin: «Sot pamë gjëra të mahnitshme»” (Luka 5:26).¹¹

Jezusi tregoi se Ai ishte dhe është përgjigjja për çdo problem në jetë!

KONKLuzion

Jezusi mund t’ju ndihmojë, pavarësisht nga problemi apo halli që keni në këtë moment. Në disa raste Ai mund ta zgjidhë problemin, siç bëri me paralizën e të sëmurit. Vetëm se sot Ai nuk do të kryejë ndonjë mrekulli si në atë rast. Ai s’vepron në të njëjtën mënyrë në ditët tona, por vazhdon të punojë sipas planit të Tij hyjnor për njerëzimin.¹² Në raste të tjera Ai do t’ju japë fuqi për të përballuar barrën e për të triumfuar mbi çdo problem në jetë!

N.q.s. dëshironi ndihmën e Perëndisë, gjëja e parë që duhet të bëni, është që në mënyrë të ndershme të analizoni marrëdhënien tuaj me Atë. Jezusi është para së gjithash i preokupuar për shëndetin tuaj shpirtëror. N.q.s. nuk jeni kristianë, duhet të pendoheni për mëkatet tuaja, të rrëfeni besimin tuaj te Jezusi dhe të pagëzoheni (duke u zhytur në ujë) për faljen e mëkateve tuaja (Marku 16:16; Veprat e Apostujve 2:38). Në qoftë se keni qenë pjesëtar i familjes së Perëndisë, por tani besimi juaj është dobësuar, ju duhet të ktheheni sa më shpejt te Jezusi, i penduar dhe me lutje (Veprat e Apostujve 8:22; Jakobit 5:16).

Kur marrëdhënia midis jush dhe Perëndisë të jetë përmirësuar, do të keni fuqi të reja që s’i keni pasur kurrë më parë. Do të keni pranë dikë që mendon dhe kujdeset për ju. Perëndia ju ka premtuar mençurinë e Tij, për të cilën ju keni nevojë për të përballuar hallet dhe problemet (Jakobit 1:5). Do të keni një familje shpirtërore që quhet kishë, një familje me shumë njerëz që mund t’ju ndihmojnë dhe t’ju mbështesin.

Kurrë mos e harroni këtë: Jezusi është për-

gjigja, madje e vetmja përgjigje (Gjoni 14:6). N.q.s. nuk e pranoni Jezusin, atëherë nuk do t’i gjeni përgjigjet e drejta, nuk do të gjeni ndonjë zgjidhje për problemet tuaja shpirtërore, por do të gjeni vetëm errësirë dhe konfuzion. Afrohuni te Jezusi tani.

SHËNIME

¹ Disa s’pajtohen me mua. Sidoqoftë, më duket se n.q.s. Jezusi mund të ngjallë të vdekurit me një fjalë, Ai mund të shërojë lebrën po me një fjalë pa e prekur.

² Disa herë që në kërkime t’i dretohem Jezusit për ndihmë, «një turmë» (një pengesë) duket sa na pengon ta bëjmë këtë. Satani bën ç’është e mundur që një pengesë e tillë të jetë gjithmonë mes nesh dhe Jezusit. Por ne duhet të arrijmë te Jezusi me çdo kusht, siç bënë 4 shokët në këtë histori.

³ Nëse një problem do të na dilte para në punën në kishë dhe ne duhet ta zgjidhnim atë problem, unë do të kisha propozuar: «Le të zgjedhim një komision që të hartojë një plan pune dhe le të takohemi pas një muaji për të shqyrtuar atë plan».

⁴ Grekët e lashtë nuk përdornin shumë teknika për të theksuar një fjalë siç përdorim ne sot (p. sh. ne sot përdorim nënvizimin apo shkrimin me gërma të pjerrëta). Ata kishin një metodë tjetër për të theksuar një fjalë, ata do ta vendosnin fjalën në krye të fjalisë ose afër fillimit të saj.

⁵ Ky koncept ishte shumë i përhapur në kohët Biblike (Jobi 4:7; 27:5–10; Luka 13:4; Gjoni 9:2). Disa herë ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis mëkatit dhe problemeve shëndetësore, si në rastin e sëmundjeve seksualisht të trans-metueshme. Megjithatë, nuk ka asnjë tregues në këtë histori që të na bëjë të mendojmë se sëmundja e të paralizuarit ishte në një mënyrë ose në një tjetër e lidhur me problemet e tij shpirtërore.

⁶ Disa të ashtuquajtur «yje» ndotin mendjet dhe shpirtrat e të atyre që i ndjekin, i dëgjojnë dhe i adhurojnë.

⁷ Luka 5:17 na tregon gjithashtu se «farisenjtë dhe mësuësit e Ligjit» ishin të pranishëm atje «nga çdo fshat i Galileësë, i Judesë dhe nga Jeruzalemi». Nuk do të përbënte ndonjë problem, nëse këta burra do të kishin ardhur me qëllime të ndershme në zemrat e tyre. Por, në të kundërt, ata nuk ishin të ndershëm në zemrat e tyre.

⁸ Termi «Biri i Njeriut» është përdorur 80 herë në tregimet e ungjillëve, 14 herë te Marku. Kjo është hera e parë që termi shfaqet te Marku.

⁹ Asnjë njeriu, asnjëherë nuk i është dhënë autoriteti për të falur mëkatet.

¹⁰ Dy rastet e tjera në të cilat Jezusi përdori autoritetin e tij për të falur mëkatet, kur ishte në tokë, janë: Gruaja kurorëshkelëse (Gjoni 8:11) dhe hajduti në kryq (Luka 23:43).

¹¹ Gjithë ungjillët theksojnë se rezultati kryesor i një mrekullie ishte që njerëzit «të lavdëronin Perëndinë». Jezusi gjithmonë i jepte lavdi Perëndisë. Të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe ne.

¹² Mrekullitë, si proces, injorojnë ligjet e natyrës ose shkojnë përmbi ato. Mënyra se si Jezusi vepron sot, është e ndryshme, ajo realizohet në harmoni me ligjet e natyrës.

Autor: *David Roper*
Marrë nga seria: “*Tako Zotin*”
© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara